

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**INNOVATE CONSULT**  
**ME SELI NË TIRANË**

Sot, më date 01/11/2023, në Tiranë,

Z. Bledar Shella, Shtetas Shqiptar, i lindur më datë 18/04/1978, në Lushnjë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, Leternjoftim ID nr. 035964300 dhe nr. personal H80418174H;

Dhe

Znj. Adelina Shella, Shtetase Shqiptare, e lindur më datë 08/12/1978, në Lushnjë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, Leternjoftim ID nr. 034271117 dhe nr. personal H86208110R;

Vendosën të krijojnë shoqërinë **Innovate Consult**, një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me termat si më poshtë:

**NENI 1.**

**SHOQËRIA TREGTARE Innovate Consult**, krijohet në formën e Shoqërisë tregtare sipas ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është person juridik privat Shqiptar. Zyra e kompanisë ndodhet në qytetin e Tiranës.

**NENI 2.**

**Emri i Shoqërisë**

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj me emrin tregtar: **Innovate Consult shpk.**

**NENI 3.**

**Objekti i veprimtarisë ekonomike**

Shoqëria ka për objekt - në përputhje me dispozitat e ligjit - këto aktivitete:

Konsulencë administrative për manaxhimin dhe planifikimin e biznesit, organizative, për shoqëritë tregtare.

Konsulencë dhe strategji në fushën e marketingut dhe telemarketingut, reklamimit, marrëdhënieve publike, kërkimeve mbi tregun.

Konsulencë tregtare/publicitare, të marketingut, të teknikave dhe produktivitetit, duke përfshirë konsulencën mbi programet e kërkimit, zhvillimit dhe prodhimit të produkteve të përgjithshme, dhënien e zgjidhjeve për problematika që lidhen me marketingun/reklamimin e produkteve dhe shërbimeve të çfarëdo natyre dhe asistencën për to.

Blerje e aksioneve në kompani shqiptare ose të huaja.  
Cdo veprimtari plotësuese dhe/ose të ngjashme në përmbushje të sa më sipër.

**NENI 4.**  
**Selia e Shoqërisë**

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga "Ali Pashe Guçia", Pall.Aurora, shk.1, ap.2, Tiranë.**

**NENI 5.**  
**Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë do jetë me vlerë 10,000 (dhjetë mijë) lekë dhe përbëhet nga 2 kuota.

Kontributi i ortakëve themelues në kapitalin fillestar, ndahet si më poshtë:

1. Z. Bledar Shella mbajtës i 50% te kapitalit themeltar me vlere 5,000 (pesë mijë) lekë.
2. Znj. Adelina Shella mbajtës i 50% te kapitalit themeltar me vlere 5,000 (pesë mijë) lekë.

**NENI 6.**  
**Kohëzgjatja e Shoqërisë**

Kompania ushtron veprimtarinë e saj për një periudhë kohore te pacaktuar.

**NENI 7.**  
**Organet drejtuese**

Referuar ligjit n. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë krijohen si më poshtë:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
2. Administratori.

Forma dhe rregullat e organizimit të Shoqërisë janë të parashikuara në statutin e Shoqërisë.

Shoqëria fillimisht administrohet nga një Administrator i vetëm i cili do të qëndrojë në detyrë për 5 vjet, i rinovueshëm, përveç rasteve kur revokohet ose jep dorëheqjen, ose për arsye të tjera ligjore.

Administrator i Shoqërisë, do të jetë znj. Adelina Shella, shtetase Shqiptare, lindur më 08/12/1978, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me nr. personal H86208110R.

Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, publik ose privat, gjithashtu në marrëdhënie juridike me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto kompetenca në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi. Shoqëria administrohet nga një Administrator i vetëm, edhe jo ortak, ose nga disa administatore edhe jo ortakë, sipas asaj që është përcaktuar në momentin e emërimit.



Kur administrimi i shoqërisë u është besuar disa personave, vendimi i emërimit përcakton në mënyrë alternative:

a) nëse administratorët do të funksionojnë në mënyrë kolegjiale, duke formuar kështu këshillin e administrimit;

b) nëse administrimi i është caktuar veçmas apo bashkërisht.

#### **NENI 8.**

Organizimi dhe funksionimi i Shoqërisë, hapja e zyrave apo degëve dytësore do të bëhet në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar dhe të Statutit.

#### **NENI 9.**

Punonjësit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë janë përgjegjës dhe duhet të kompensojnë kompaninë për dëmet e shkaktuara me dashje për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 10.**

##### **Ligji në fuqi**

Veprimtaria e shoqërisë do të drejtohet nga rregullat e statutit të nënshkruar nga anëtarët themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

#### **NENI 11.**

##### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me themelimin e shoqërisë do të zgjidhet nga ortaket në të kundërt mosmarrëveshjet do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

#### **NENI 12.**

##### **Dispozitat përfundimtare**

Akti i themelimit hartohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe dhe pasi u lexua nga anëtari përbërës, u konstatua në përputhje me vullnetin e tij të lirë dhe nënshkruhet pa asnjë vërejtje.

#### **ORTAKËT THEMELUES**

**Bledar Shella**



**Adelina Shella**

